



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1827, datë 16/12 2008

PËR

**PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË MODERNIZIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 19 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të pikës 4, të Vendimit nr.521, datë 08.08.2007 të Këshillit të Ministrave "Për Procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr.1403, datë 27.10.2008,

URDHËROJ:

1. Në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të ngrihet dhe të funksionojë Bordi i Modernizimit i Forcave të Armatosura.
2. Përbërja e Bordit të Modernizimit të jetë si më poshtë:

-Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA	Kryetar
-Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA	Anëtar
-Komandanti i Forcës së Bashkuar	Anëtar
-Komandanti i Brigadës Detare	Anëtar
-Komandanti i Brigadës Ajrore	Anëtar
-Komandanti i Mbështetjes	Anëtar
-Komandanti i Doktrinave dhe Stërvitjes	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Zbulimit	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Mbrojtjes	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Ndërlidhjes	Anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Menaxh. të Bur. të Mbrojtjes	Anëtar
✓ Shefi i Sektorit të Planifikimit Strategjik në J-5	Sekretar

Protokollues i Bordit të Modernizimit të caktohet n/oficer i planifikimit në Sektorin e Planeve Strategjike në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes.

Sekretari dhe Protokolluesi i Bordit të Modernizimit nuk kanë të drejtë vote.

3. Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit në Ministrinë e Mbrojtjes merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Modernizimit, pa të drejtë vote.

4. Bordi i Modernizimit kryen funksionet e mëposhtme:

-Shqyrton kërkesat operationale të hartuara nga strukturat e gjenerimit të tyre;

-Miraton: armët, municionet, apo pajisjet e materialet ushtarake, veçmas apo si pjesë e një sistemi dhe i shërbimeve të lidhura me to, për të cilat do të zbatohet Vendimi nr.521, datë 08.08.2007 i Këshillit të Ministrave "Për Procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik", i ndryshuar;

-Vlerëson e miraton nga ana operationale dhe funksionale propozimin teknik, projektin e plotë apo programin e integruar të hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit (DMPM).

5. Marrja e vendimeve të Bordit të Modernizimit të bëhet në dy faza:

-Faza e parë : shqyrtimi i kërkesave operationale të paraqitura nga komandat kryesore dhe drejtoritë në Shtabin e Përgjithshëm si dhe përcaktimi i llojeve të mallrave.

-Faza e dytë : shqyrtimi i propozimit teknik të sistemeve dhe pajisjeve, projektit të plotë apo programit të integruar të paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit (DMPM).

6. Ministri i Mbrojtjes, pas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, shprehet për vijimin e procedurave të mëtejshme, sipas vendimit të Bordit të Modernizimit.


7. Mënyra e funksionimit të Bordit të Modernizimit të bëhet sipas Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhëri.

8. Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes Nr.584, datë 24.12.2003 "Për krijimin e Komisionit të Kërkesave për Sisteme dhe Pajisje Luftarake, me të cilat do të kompletohen Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimi i Ministrit të Mbrojtjes Nr.96, Datë 26.02.2004 "Për procedurat e punës së Komisionit të Kërkesave për Sisteme dhe Pajisje Luftarake për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", revokohen.
9. Me këtë urdhër të njihen të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
10. Përgjigjet për zbatimin ekëtij urdhëri Kryetari i Bordit të Modernizimit dhe anëtarët e tij.
11. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

GAZMEND OKETA



MËNYRA E FUNKSIONIT TË BORDIT TË MODERNIZIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Bordi i Modernizimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (BM), në punën e tij bazohet në vendimin nr.521, datë 08.08.2007 të Këshillit të Ministrave "Për Procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik", i ndryshuar, dokumentet, programet dhe planet kryesore të zhvillimit të Forcat e Armatosura duke vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Detyrat e BM:

- Shqyrton kërkesat operacionale/ detyrën e projektimit të hartuara nga strukturat e gjenerimit të tyre.
- Analizon, studion dhe bën klasifikimin dhe vlerësimin e mallrave (armëve, municioneve, materialeve luftarake, etj) dhe shërbimeve që lidhen me to, që përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik.
- Vlerëson e miraton nga ana operacionale dhe funksionale propozimin teknik, projektin e plotë të hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit (DMPM).

3. Mbledhjet dhe vendimet e BM:

- BM mblidhet sipas planit vjetor të punës, i cili hartohet dhe miratohet nga kryetari i tij dhe në raste të veçanta me urdhër të Shefit të SHPPFA.
- Mbledhjet e Bordit janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e numrit të antarëve të Bordit. Ato janë të mbyllura dhe për to mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje si dhe nga Sekretari i Bordit.
- Rendi i ditës për mbledhjen e rradhës të Bordit hartohet nga sekretari i bordit dhe miratohet nga Kryetari i Bordit, i cili cakton afatin dhe vendin e mbledhjes. Sekretari njofton anëtarët e bordit dhe u vë në dispozicion dosjen përkatëse.
- Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen pjesëmarrësve të Bordit nga sekretari i tij jo më vonë se dy ditë para ditës së caktuar për mbledhje. Kur informacioni i nevojshëm kërkon me shumë kohë për t'u përpunuar, kryetari mund të zgjasë afatin e thirrjes së Bordit.

para ditës së caktuar për mbledhje. Kur informacioni i nevojshëm kërkon me shumë kohë për t'u përpunuar, kryetari mund të zgjasë afatin e thirrjes së Bordit.

- Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, Kryetari i Bordit ka të drejtë të kërkojë ekspertë.
- Relatimi i kërkesave operacionale në BM, bëhet nga titullari i strukturës gjeneruese të kërkesës.
- Vendimet e BM merren me 2/3 e votave të antarëve Bordit.
- Secili anëtar që voton kundër është i detyruar të shpjegojë objeksionet e tij, të cilat i bashkëngjiten vendimit të Bordit.
- Vendimi duhet të jetë i argumentuar dhe i bazuar, duke përmendur në detaje referencat që kanë shërbyer si bazë për marrjen e këtij vendimi.
- Vendimet e Bordit i përcillen me informacion të detajuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, i cili ia përcjell vendimin Ministrit të Mbrojtjes. Pasi shprehet Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Ministrit të Mbrojtjes, vendimet i kalojnë për zbatim e menaxhim të mëtejshëm Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit.
- Vendimet e BM që lidhen me procesin e modernizimit të sistemeve dhe pajisjeve janë:
- Plani vjetor i punës i BM, për shqyrtimin e kërkesave operacionale të modernizimit të përgatitura nga strukturat e gjenerimit të kërkesave operacionale.
- Propozimin teknik të sistemeve dhe pajisjeve, projekin e plotë apo programin e integruar të përgatitur nga DMPM.
- Përcaktimet e mallrave apo produkteve për qëllime të mirëfillta ushtarake, të cilët bëjnë përjashtim nga mallrat e prodhimit komercial.

Detyrat e Kryetarit të BM:

- Drejton mbledhjet e bordit.
- Siguron zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në marrjen e vendimeve.
- Vendos për rendin e ditës për çdo mbledhje, si dhe për datën dhe kohën e mbledhjes së radhës.
- Thërret mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, sipas nevojave.
- Voton i fundit për miratimin e çdo kërkesë operacionale, projekti apo marrëveshje.
- Nënshkruan bashkë me sekretarin procesverbalin, pas miratimit nga të gjithë anëtarët e BM.
- Paraqet tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Ministri i Mbrojtjes të gjitha vendimet që merren në bord, para se ato të

5. Detyrat e Sekretarit të BM:

- Administron gjithë dokumentacionin e punës së BM.
- Mban procesverbalin në mbledhjet e BM.
- Merr nënshkrimin e të gjithë antarëve të BM në procesverbalet e mbledhjeve.
- Protokollon dokumentat e përgatitura dhe të miratuara nga BM.
- Përgatit dosjen e vendimeve, bashkë me praktikat përkatëse për pajisje dhe modernizim dhe ia paraqet atë Kryetarit të BM.
- Nënshkruan së bashku me kryetarin procesverbalin pas miratimit nga të gjithë anëtarët e BM.

6. Detyrat e anëtarëve të BM:

- Marrin pjesë në mbledhje dhe diskutojnë në Bord për çështjet që lidhen me miratimin e kërkesave operacionale dhe projekteve apo të programeve përkatëse.
- Marrin pjesë në votim.
- Njihen me rendin e ditës të paktën 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.
- Përgatiten për diskutim, propozojnë dhe japin mendime të argumentuara në lidhje me çështjet përkatëse.
- Nënshkruajnë procesverbalin dhe nuk kanë të drejtë abstenimi në rast se nuk kanë pengesë ligjore për të votuar.
- Ata mund të votojnë kundër, duke bërë sqarimet përkatëse, të cilat do të pasqyrohen në dokumentacionin e BM.

7. Detyrat e protokolluesit:

- Përgjigjet për administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në BM.
- Mban procesverbalet dhe protokollon dokumentacionin e BM në libër të veçantë.

LISTA E KKSP 2008

Nr	Gradë/Emër/mbiemër	Detyra	Firma
1	Gjeneral Brigade Agim LALA	Komandanti i Forcës së Bashkuar	
2	Gjeneral Brigade Vladimir QIRJAZI	Komandanti i Komandës Mbështetëse	
3	Kolonel Sandër LLESHI	Komandanti i Doktrinave dhe Stërviçjes	
4	Kolonel Dhori SPIROLLARI	Zv/komandanti i Brigadës Ajrore	
5	Kapiten i Rang. II Roland NASTO	Shef Shtabi i Brigadës Detare	
6	Kolonel Hysen CEKODHIMA	Drejtori i Drejt. Operat. dhe të Stërviçjes	
7	Kolonel Dilaver HOXHA	Drejtori i Drejt. së Planifikimit Ushtarak	
8	N/kolonel Jorgo MINO	Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës	
9	N/Kolonel Ferdinand DHIMO	Shef i Sektorit të Planifikimit, J6	
10	Kolonel Ruzhdi RUSTEMI	Drejtori i Drejt. së Men. Bur. Të Mbrojtjes	
11	Zoti Gjergji PIJONI	Përfaqësues Drejt. Harm.Ligj Marrdh.Kuvendin	
12	Zoti Fatbardh KUÇI	Drejtori i Inst. të Stud. e Proj. të Mbrojtjes	
13	Kolonel Adriatik HOXHA	Shefi i Qendrës së Zhvillimit të Sistemeve	

LISTA KKSP 2007

Gradë/Emër/mbiemër	Detyra	Firma
Gjeneral Major Shpëtim SPAHIU	Komandanti i Forcës së Bashkuar	
Gjeneral-Brigade Zija BAHJA	Komandanti i Mbeshtetjes	
Kolonel Sandër LLESHI	Komandanti i Doktrinave dhe Stërviçjes	
Gjeneral Brigade Astrit JAUPI	Komandanti i Brigadës Ajrore	
Kapiten i Rang. I Kristaq GERVENI	Komandanti i Brigadës Detare	
Kolonel Hysen CEKODHIMA	Drejtori i Drejt. Operat. dhe të Stërviçjes	
Kolonel Thimi HUDHRA	Drejtori i Drejt. së Planifikimit Ushtarak	
Kolonel Dashnor CAUSHI	Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës	
Kolonel Çesk MILLJA	Drejtori i Drejtorisë së Ndërlidhjes	
Kolonel Bardhyl HOXHA	Drejtori i Drejt. së Men. Bur. Të Mbrojtjes	
Zoti Ndue MARKU	Drejtori Drejt. Harm.Ligj Marrdh.Kuvendin	
Zoti Fatbardh KUÇI	Drejtori i Inst. të Stud. e Proj. të Mbrojtjes	
Kolonel Adriatik HOXHA	Shefi i Qendrës së Zhvillimit të Sistemeve	